



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.78

Prishtinë, më 20.1.2017, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyqi

Mungoi Bekim Haxhiu, Sërgjan Popoviq dhe Mufera Shinik

Përfaqësues të ftuar: Ministri i MKRS-së

Përfaqësues të tjerë: KDI, NDI dhe Media

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i proceverbalit të mbledhjes së mbajtur me 17.1.2017;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor në mes Kosovës, Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Serbisë;**
- 4. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2017;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i proceverbalit të mbledhjes së mbajtuur me 17.1.2017;

Anëtarët e Komisionit miratuan procesverbalin e mbledhjes së datës 17.1.2017 me vërejtjen e Ismajl Kurteshit që në procesverbal të përfshihet propozimi i tij për marrjen e nismës për hartimin e Projektligjit për mbrojtjen e gjuhës standarde shqipe.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor në mes Kosovës, Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Serbisë;

Për këtë pikë të rendit të ditës, Kryetari Nait Hasani tha se Komisioni ka ftuar Ministrin e MKRS-së me qëllim që të njoftohen në detaje rreth Projektligjit për Ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor në mes Kosovës, Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Serbisë.

Në fjalën e tij Ministri i MKRS, Kujtim Shala tha se kjo është një marrëveshje ndërkombëtare mjaftë e rëndësishme për rininë e Kosovës dhe se kjo marrëveshje do të sjelli shumë përfitime si në aspektin financiar, ashtu edhe në aspektet e tjera siç janë ato kulturore, shkëmbim përvojash, qasje në programet e BE-së që kanë të bëjnë me rininë, etj. Ai më tej shpjegoi se kjo marrëveshje vjen si rezultat i nismës rajonale për Ballkanin Perëndimor i njohur ndryshe si Procesi i Berlinit, nismë kjo e iniciuar dhe mbështetur nga Gjermania dhe Franca dhe se idea e kësaj iniciative është e njejtë me atë që kanë hartuar dhe zbatuar vetë këto dy shtete, rezultati i së cilës ka qar në pajtimin e tyre, qëllim ky i cili ngërthehet edhe në këtë iniciativë. Vlenë të theksohet se Ministri Shala, shpjegoi se ky Projektligj nuk ka të bëjë asgjë me dialogun e Brukselit, duke prezentuar edhe përbërjen që do të ketë kjo Zyre Rajonale, e cila do të ketë bord drejtues, sekretariat, organ që do të udhëhiqet me rotacion si dhe bordin këshilldhënës. Në ekspozitën e tij, Shala shtoi se është vendosur që Zyra kryesore e kësaj iniciative është vendosur të jetë Tirana, e cila sipas tij ka qenë një zgjedhje e mirë dhe e arsyeshme. Shala përbylli prezentimin e tij duke theksuar që përfitimet e fondeve do të jenë në proporcion me kontributin e dhënë për këtë iniciativë, buxheti dhe përqindja e së cilit është caktuar të jetë mbi 2mil. Euro.

Ismajl Kurteshi, paraqiti vërejtjet e tij në lidhje me këtë Projektligj duke theksuar që palët nënshkruese të saj nuk janë të barabarta në kuptimin e subjektivitetit dhe shtetësisë së shteteve pjesëmarrëse. Ai tha se formulimet dhe referimi për shtetet nënshkruese është i papranueshëm dhe paraqet parabarzi.

Ministri Shala në lidhje me çështjen e ngritur nga Ismajl Kurteshi tha se formulimet në këtë marrëveshje janë sipas Samitit të mbajtur në Paris ndërsa për fusnotën tha se është derivat i dal nga zhvillimet e mëhershme. Ai në fund të përgjigjes së tij, tha se të gjitha palët nënshkruese janë të barabarta në këtë marrëveshje.

Shpejtim Bulliqi në fjalën e tij tha se e mbështet këtë Projektligj dhe se pret që rinia të përfitojë nga projektet e parapara dhe bëri thirrje që ato të jenë reale dhe të realizueshme, rezultatet e të cilave do të ndikonin pozitivisht për rininë.

Teuta Haxhiu tha se do të abstenojë për Projektligjin në fjalë pasi që tha ka nevojë për diskutim brenda partisë të cilën përfaqëson.

Salih Morina theksoi se kjo është një Marrëveshje Ndërkombëtare dhe e cila përben interes për Kosovën, përmes të cilës do të përfitojmë shumë dhe shtoi që është obligim i Komisionit që ta procedojë për Kuvend dhe aty të vendoset për Projektligjin.

Shukrije Bytyqi e përshëndeti këtë marrëveshje dhe bëri thirrje që Kosova të jetë e përfaqësuar sa më dinjitetshëm në këtë Marrëveshje duke provomuar vlerat që kemi.

Në fund të diskutimit, Komisioni vendosi që këtë Projektligj ta procedojë për miratim në seancë plenare. Projektligji u miratua me 4 vota për, 1 abstenim dhe 1 votë kundër.

4. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2017;

Në vazhden e diskutimit për planin e punës së Komisionit, pikë kjo e diskutuar edhe në mbledhjen paraprake, Nait Hasani tha se ky plan i cili gjatë shqyrtimeve të mëvonshme mund të pësoj ndryshime sipas nevojave dhe prioriteteve parasheh shqyrtimi i gjithsej pesë projektligjeve si dhe shqyrtimi i raporteve të organeve të pavaruara që kanë të bëjnë me fushëveprimtarin e komisionit. Ai shtoi se për realizimin e këtij plani komisioni do të mbajë takime të rregullta, dëgjime publike, vizita si dhe do të bashkëpunojë me të gjithë akterët relevant vendor dhe ndërkombëtar.

Vlen të theksohet se që nga mbledhja e fundit e Komisionit ku u vendos që Ministrive të linjës të u kërkojnë rishikimin e mundësive për ricaktim më të hershëm të afateve të parapara, sepse aktualisht, me afatet e paracaktuara, ato nuk do të mund të diskutoheshin dhe trajtoheshin nga Komisioni, MASHT dhe Ministria e Diasporës nuk kanë sjell në Komision planin e ndryshuar legjislativ.

5. Të ndryshme;

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani